

NEWSLETTER

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Merr udhë projekti UBT- BOKU 2030

Nisi puna për implementimin e projektit UBT-BOKU 2030, i celebruar vetëm një muaj më parë. Në këtë fazë po diskutohet mbi kriteret dhe treguesit që lidhen me ofertën akademike, procesin mësimor dhe të gjithë aspektet e tjera në kuadër të kësaj fushe. Pas prezantimit të drejtuesit të projektit Dr. Thomas Koller, përfaqësuesi i BOKU që do të qëndrojë në UBT një pjesë të konsiderueshme kohore gjatë realizimit të projektit, ekipi i BOKU i përbërë nga Prof. Hubert Hasenauer dhe Prof. Hans Peter Kaul prezantuan ofertën akademike dhe eksperiencën e BOKU, si dhe sqaruan treguesit që do të duhen për të filluar procesin e analizës së situatës në UBT. Gjatë kësaj faze parashikohet përgatitja e një analize gjithëpërfshirëse të ofertës aktuale akademike të UBT duke integruar edhe dokumentet ekzistuese përveç çdo “fushe” të pambuluar ende.



MË TË LEXUAR:

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/SQ/BLOG/UNIVERSITETI-13/MERR-UDHE-PROJEKTI-UBT-BOKU-2030-536](https://www.ubt.edu.al/sq/blog/universiteti-13/merr-udhe-projekti-ubt-boku-2030-536)

UBREEN

Follow us:



UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQËSOR
_TIRANES



NDËRKOMBËTARIZIMI DHE MUNDËSI SHKËMBIMI

UBT- BOKU 2030 mundësia e artë për çdo student që zgjedh UBT, diploma duale dhe ofron programe shkëmbimi



Bursa Studimi SA PAGA MINIMALE

PËR PROGRAMET PRIORITARE TË STUDIMIT
PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit



PROGRAME AKADEMIKE TË SPECIALIZUARA

Pse duhet të regjistrohesh në UBT për të studiuar?

Inaugurohet Laboratori Horti Smart Lab, laborator i ri në UBT pranë Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit

Horti Smart Lab, në funksion të kërkimit dhe këshillimit në prodhimin dhe ruajtjen e frutave e perimeve, është një laborator i bujqësisë smart (të mençur) që do të kryejë kërkim shkencor dhe do të ofrojë shërbime duke përdorur kryesisht metoda jo-shkatërruese për vlerësimin e cilësisë dhe maturimin e frutave, rrushit, perimeve etj; vlerësimin e përbërjes dhe cilësisë së tyre (ngjyra, pesha, fortësia, aciditeti, përmbajtja e lëndëve të ngurta të tretshme, përmbajtja e lëndës së thatë) si dhe përmbajtjen e etilenit, acideve organike dhe sheqernave në fruta.



Kurs Trajnimi “Hyrje në Sistemet e Informacionit Gjeografik”

Kurs organizohet në kuadër të projektit Ngritja e Qendres Gjeoinformative për Ballkanin Perëndimor në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Me pjesëmarrjen e rreth 22 pjesëmarrësve, përfaqësues të komunitetit shkencor dhe akademik të disiplinave të ndryshme, si dhe përfaqësues nga institucione të ndryshme shtetërore të ardhur nga vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, QTTB Fushë-Krujë dhe staf i interesuar i UBT, ky kurs do t'ju sigurojë pjesëmarrësve njohuri thelbësore dhe aftësi praktike në përdorimin e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS) dhe analizën e të dhënave hapësinore. Në përfundim të trajnimit u shpërndanë certifikatat e para për pjesëmarrësit.



**Universiteti Bujqësor i Tiranës
bëhet pjesë e Konferencës
Ndërkombëtare: “Kontrolli i
cilësisë së ajrit dhe ujit: Faktorë të
rëndësishëm në mbrojtjen e
shëndetit të njeriut dhe ambientit
për zhvillim të qëndrueshëm”.**

Zëvendës Rektorja për Shkencën dhe Projektet, Prof. Dr. Erinda Lika ishte një ndër drejtueset e sesionit “Prespektivat aktuale mbi cilësinë e ajrit dhe të ujit”, ndërsa prezantoi edhe përvojën e saj shkencore mbi rolin e ujërave të zeza si komponent kryesor i qëndrueshmërisë dhe përhapjes në gjenet e rezistencës antimikrobike që ndikojnë në cilësinë e shëndetit mjedisor në Shqipëri.

